



“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

STATUTI i Shoqatës

“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË”

Sipas Legjislacionit shqiptar, Ligjit Nr. 8788 datë 07. 05. 2001, “Për Organizatat Jo fitimprurëse” dhe Ligji Nr. 8789 datë 07. 05. 2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”:

Ne, Anëtarët e ASAMBLESE, me vullnetin tonë të lirë:

në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të zhvilluar në Tirane , në datën 26.03.2017, miratojmë këtë Statut për organizimin, funksionimin dhe drejtimin e shoqatës “**FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË**”

KREU I Dispozita të përgjithshme

Emërtimi Neni 1

1.1. Organizata mban emërtimin shoqata “**FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË**”, me inicialet **FOSH**

Forma e Organizatës Neni 2

- 2.1. Shoqata “**FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË**” është organizuar në formën e një shoqate me anëtarësi, jofitimprurëse, joqeveritare, jopolitike.
- 2.2. Ajo krijohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi Organizatat Jofitimprurëse dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 2.3 Ajo është një bashkim vullnetar dhe frymëzohet nga parimet e solidaritetit dhe zhvillimit njerëzor.





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

2.4. Veprimtaria e saj bazohet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe në parimet dhe normat ndërkombëtare.

Neni 3

3.1. Shoqata ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga partitë politike, institucionet fetare, nga organet dhe institucionet shtetërore.

Selia

Neni 4

4.1. Shoqata “FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË” e ka selinë në Tiranë, në adresë: Rruga « ASIM VOKSHI », Nd. 10, Njesia Bashkiake Nr.9, Kodi Postar. 1016.

4.2. Selia e Shoqatës mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

4.3. Shoqata do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, ku gjen përkrahës e mbështetës të veprimtarisë të saj.

4.4. Shoqata mund të krijojë Degë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Vula dhe Stema e Organizatës

Neni 5

5.1. Shoqata do të ketë vulën dhe stemën e saj të veçantë e cila do të identifikojë çdo dokument që i përket asaj.

5.2. Vula do të përmbajë tekst në gjuhën shqipe: “FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË”

5.3. Përdorimi i vulës dhe stemës fillon që nga dita e data e fitimit të personalitetit juridik të Organizatës.

5.4. Vula dhe stema e organizatës njihen dhe pranohen nga të tretët duke filluar nga data e fitimit të personalitetit juridik të organizatës.

Kohëzgjatja

Neni 6

6.1. Shoqata “FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARË” do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pakufizuar kohe.

6.2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë një afat për ushtrimin e veprimtarisë së shoqatës sipas procedurës dhe me shumicën e kërkuar për ndryshimin e statutit. Limiti i afatit vendoset me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

6.3. Ky afat vendoset vetëm me shumicën e kërkuar për ndryshimin e statutit të organizatës.

Qëllimet dhe fusha e veprimtarisë

Neni 7

7.1. Shoqata, duke parë eksperiencën e vendeve Europiane, ka për qëllim të veprimtarisë:

- ❖ Shoqata synon edukimin, mbrojtjen, shtimin e të gjithë specieve të zogjve, kultivimin e tyre nga njeriu dhe jetesën e tyre në gjendje të egër.”
- ❖ Nepermjet anëtarësimit në të, të rritesve dhe mbareshtuesave, të nxise dhe përhape sistemet e korrigjuara të mbarështimit, të kujdeset për riprodhimin dhe ekspozimin e zogjve decorative e kengetare që mund të mbijetojnë vetëm





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

- nepermjet mbareshtimit nga njeriu. Ajo është e interesuar, per mbrojtjen e të gjithë specieve të zogjve si dhe me problemet ekologjike dhe mjedisore te lidhura me ta;
- ❖ Te formalizojë kultivimin e specieve te kanarinave me vlera nderkombetare si dhe te nengrupit te kanarinave gjysme endemike te vendit.
 - ❖ Te nxise perfaqesimin e rritesve Shqiptare ne konferencat, takimet shumepaleshe, ekspozitat apo konkurset nderkombetare sipas llojeve dhe kategorive.
 - ❖ Mbrojtjen, rritjen, zhvillimin e trashëgimisë autoktone te zogjve ekzotike e kengetare si dhe studimin e tyre, me qëllim , ruajtjen e llojeve të mbrojtura

Neni 8

8.1. Për realizmin e qëllimeve të saj shoqata, do të bashkëpunojë me shoqata të tjera si motra të cilat veprojnë në Shqipëri si dhe jashtë vendit, me Organizatat Kombëtare e Ndërkombëtare si dhe institucionet publike e jo publike, personat fizik e juridik shqiptar ose të huaj.

Ajo do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- ❖ Te koordinoje dhe lehtësoje kontaktet dhe kembimet e ekperiences mes kultivuesve vendas dhe atyre te huaj.
- ❖ Nepermjet antareve te saj te mbaje regjistrin e te gjithë personave qe mbareshtrojne, shumojne individe ne gjendje jo te lire. Te regjistroje individet e lindur dhe rritur ne keto kushte dhe te informoje Autoritetin menaxhues perkates ne Ministri nje here ne vit brenda dates 30 Shtator.
- ❖ Te ndihmoje anëtarët e saj në fermat e tyre;
- ❖ Te nxise dhe organizojë ekspozita dhe panairë të zogjve me nismën e saj ose të organizatave si motra qe kryejne veprimtarine e tyre jashte kufijve te Shqiperise;
- ❖ Te organizojë takime të rregullta dhe studime, konferenca dhe kurse me përmbajtje edukative për te popullarizuar idete e saj lidhur me jeten, mbareshtimin dhe ruajtjen e zogjve;
- ❖ Te zhvilloje projekte edukuese për mbarështimin amator te zogjve dekorative dhe kengetare,per njohjen dhe zhvillimin e trashëgimisë autoktone nepër shkolla, qendra të komunitetit, klube, etj.;
- ❖ Te bashkëpunojnë me organizatat tjera për ruajtjen e racave te pastra te zogjve;
- ❖ Te inkurajojnë anëtarët, brenda kufijve të mundësisë, në furnizimin e pajisjeve për zogjte dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për të gjitha aktivitetet institucionale.
- ❖ organizimin e seminareve, simpoziumeve, programeve të trajnimit, ruajtjes, promovimit te eksperiencave te mbareshtimit te edukoje dhe perhape dashurine per mbareshtimin e shpendeve duke rritur numrin e dashamiresave te tyre.
- ❖ zhvillimin, publikimin dhe qarkullimin e materialeve (revista, gazeta e broshura) që trajtojnë çështje në lidhje rritjen e kanarinave.
- ❖ sponsorizimi dhe menaxhimi i çdo lloj veprimtarie tjetër që shërben në realizimin e qëllimit të shoqatës.





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

- ❖ mbajtja e raporteve me organizata dhe shoqata analoge të huaja për arritjen e qëllimit të shoqatës
- ❖ çdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji.

KREU II

Burimet dhe mjetet financiare

Neni 9

9.1. Burimet financiare Shoqata i siguron nga kuotat e anëtareve, nga donacionet e shtetit, te fondacioneve, organizmave apo personave te tjerë juridike publike apo private si dhe nga çdo veprimtari tjetër e ligjshme e saj.

9.2 Asetet e shoqatës do të shërbejnë për të përmbushur qëllimin e shoqatës dhe kryerjen e aktiviteteve të saj

9.3. Shoqata mirëpret çdo ndihmë materiale në sende e të holla brenda ligjshmërisë të burimeve të këtyre ndihmave.

9.4. Të ardhurat dhe shpenzimet për aktivitetin e shoqatës miratohen nga Mbledhja e Përgjithshme.

9.5. Shoqata do të ketë llogarinë e saj në një nga Bankat e Republikës së Shqipërisë.

9.6. Shoqata, për sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e qëllimit të saj dhe në konformitet me legjislacionin shqiptar, mund të formojë e të kryejë veprimtari ekonomike dhe dytësore, ndihmëse, siç janë: reklama dhe propagandë; shërbime fotografike, shërbimet e paketimeve; përgatitja dhe publikimi e; veprimtari e bibliotekave dhe arkivave, aktivitete sportive; aktivitete kulturore dhe rekreative të papërmendura më lart; mund të marrë pjesë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.

Shoqata mund të kryej operacione me pasuri të paluajtshme, të luajtshme, financiare dhe tregtare për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të saj

Administrimi i të ardhurave financiare

Neni 10

10.1. Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse.

10.2. Shoqata ka të drejtë të ketë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të tyre si dhe nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive të tjera në përputhje me qëllimin dhe objektivat e saj.

10.3. Shoqata mund të ushtrojë dhe veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për qëllimet dhe synimet e saj, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës dhe të ardhurat e saj të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

10.4. Të ardhurat e shoqatës do të përdoren për përmbushjen e qëllimit të





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

saj, ashtu siç përcaktohet në statut. Asnjë pjesë e burimeve financiare nuk do të paguhet, transferohet apo të shpërndahet direkt ose në mënyra të tjera, Këshillit Ekzekutiv, anëtarëve, punonjësve ose të tretëve, në formën e fitimit, kompensimit ose të përfitimit financiar e material, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të, ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të shoqatës.

10.5. Për arritjen e objektit të saj, ajo mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me të tretët, por gjithmonë në kuadrin e objektit të veprimtarisë së saj.

10.6. Përfundimi i ushtrimit financiar behet ne 31 Dhjetor të çdo viti

Neni 11

11.1. Mjetet financiare mund të transferohen nga dega në degë apo në shoqatë me vendim të këshillit ekzekutiv të shoqatës dhe miratim të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU III

Anëtarësia

Neni 12

12.1. Anëtar i shoqatës mund të jetë çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se është me punë të përkohshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe çdo i huaj i cili jeton, qoftë edhe përkohësisht, në Republikën e Shqipërisë i cili pranon statutin e shoqatës, programin e punës

Neni 13

13.1. Anëtarësimi në shoqatë realizohet:

- Anëtarësi individuale dhe,
- Anëtarësi kolektive, si persona juridik publik apo privat

13.2. Anëtarët e shoqatës mund të jenë:

- ❖ Aktivë –
- ❖ Anëtarë ndihmës -
- ❖ Donatorë
- ❖ Anëtarë nderi

Neni 14

14.1. Për pranimin në shoqatë, nuk bëhet ndonjë dallim nga gjendja shoqërore, kombësia, raca, feja dhe seksi.

14.2. “Shoqata organizohet në bazë territoriale, dhe anëtarësimi është i lirë, i hapur për të gjithë personat fizike dhe juridikë të cilët anëtarësohen lirisht me plotësimin e formularit të aplikimit.”

- 14.3 “Statusi i antarit fitohet formalisht në momentin e mbledhjes së rradhës së Asamblesë së Përgjithshme e cila mund të refuzojë pranimin e një antari të ri vetëm nëse ekzistonë një nga kushtet e nenit 15 të Statutit.”





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

Neni 15

15.1. Nuk pranohen si anëtarë, ata persona, grupime apo organizata të cilët më parë kanë marrë pjesë në aktivitete në dëm të organizatës dhe qëllimeve të saj si dhe persona që janë përjashtuar nga anëtarësia sipas dispozitave të Statutit dhe rregullores.

15.2. Në rast se personi, grupime apo organizata kane treguar se ka ndryshuar qëndrim dhe dëshiron të punojnë për realizimin e qëllimeve të organizatës ato mund të pranohet si anëtar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e saj më të afërt.

15.3. Deri në miratimin e Asamblesë ai mund të pranohet si anëtar – ndihmës pa të drejta pjesëmarrjeje aktive në aktivitetet e organizatës.

15.4. Anëtarësia në një organizatë tjetër të tillë nuk përjashton mundësimin e anëtarësisimit, por me kusht që anëtari, grupimi apo organizata të mos kryejë veprimtari që janë në dëm të shoqatës.

Neni 16

16.1. Anëtarë aktivë janë qytetarët me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë të cilët paguajnë kuotacionin dhe aktivisht inkuadrohen në punët e shoqatës.

16.2. Anëtarë aktivë mund të jenë edhe qytetarë të huaj të cilët përkohësisht ose përgjithmonë jetojnë në Republikën e Shqipërisë

Neni 17

17.1. Anëtarë ndihmës, donatorë dhe dhënësit e ndryshëm të dhuratave e të të falurave, mund të jenë persona fizik apo juridik publik apo privat, të cilët e ndihmojnë shoqatën.

Neni 18

18.1. Individë të ndryshëm, që me punën e tyre, me meritat e tyre kanë dhënë kontribut të veçantë me në realizimin e programit dhe qëllimeve të organizatës, mund të shpallen Anëtarë Nderi.

18.2. Anëtarët e Nderit mund të jenë anëtarë të organizatës ose jashtë anëtarësisë së saj.

18.3. Anëtarët e Nderit zgjidhen nga Këshillit Ekzekutiv me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

18.4. Titulli anëtar nderi mund të jepet me anë të një ceremonie të veçantë dhe të shoqërohet me një certifikatë të posaçme.

18.5. Anëtarët e Nderit kanë të gjitha të drejta e detyrat e anëtarëve të tjerë. Përveç këtyre ata kanë të drejta të veçanta me karakter formal e ceremonial të cilat përcaktohen në rregulloren e brendshme.

18.6. Anëtarët e Nderit mund të përjashtohen nga një ose disa detyrime të antarëve të tjerë me vendim unanim të Këshillit Ekzekutiv.

Procedurat e Pranimit

Neni 19

19.1. Çdo person që dëshiron të bëhet anëtar i organizatës, plotëson formularin e anëtarësisimit të hartuar nga Këshillit Ekzekutiv si dhe një deklaratë me shkrim, me anë të





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

së cilës ai pranon të punojë për realizimin e qëllimit, statutit, akt themelimit dhe rregulloreve të organizatës.

19.2. Në rast se anëtarësimi i tij nuk pranohet personi ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Të Drejtat dhe detyrat e Anëtarëve

Neni 20

20.1. Anëtari aktiv ka të drejtë:

- ❖ Të zgjedhë dhe të zgjidhet për organet drejtuese të Organizatës.
- ❖ Të propozojë dhe të marrë pjesë në aprovimin e Programit të aktivitetit dhe në realizimin e qëllimit e detyrave të shoqatës.
- ❖ Të marrë pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese dhe të Asamblesë së Përgjithshme.
- ❖ Të shprehë lirisht mendimin e tij me shkrim ose me gojë në organet drejtuese të organizatës për mbarëvajtjen dhe administrimin e saj.
- ❖ Të marrë pjesë në veprimtaritë e Organizatës në përputhje me statutin.
- ❖ Të kërkojë nga organet drejtuese të Organizatës, ndihmën, informacionin e nevojshëm si dhe të njihet me aktivitetet që organizohen.
- ❖ Të bëjë propozime dhe sugjerime për veprimtarinë e shoqatës dhe t’ia paraqesë Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë.
- ❖ Të heqë dorë nga pjesëmarrja në shoqatë kur ta shohë të arsyeshme.
- ❖ Të marrë pjesë aktive si pjesëmarrës i thjeshtë apo si organizator në çdo aktivitet tjetër të shoqatës.
- ❖ Të aftësohet për zbatimin e detyrave konkrete të shoqatës
- ❖ Të posedojë Librezën e Anëtarësisë
- ❖ Të hyjnë dhe të përdorin të gjitha strukturat sportive e krijuese të disponueshme nga shoqata.

Neni 21

21.1. Anëtari i Organizatës ka këto detyra:

- ❖ Të respektojë dhe të zbatojë me seriozitet dhe disiplinë maksimale statutin, vendimet, rregulloret, urdhëresat e aktet e tjera që rregullojnë jetën e brendshme të strukturave të shoqatës.
- ❖ Të marrë pjesë në aktivitetet që organizon shoqata.
- ❖ Të ndihmojë shoqatën për realizimin e misionit të saj.
- ❖ Të mbrojë dhe promovojë veprimtarinë e shoqatës.
- ❖ Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve të shoqatës.
- ❖ Të mbajë pastër figurën e tij morale për të mos dëmtuar autoritetin dhe personalitetin e shoqatës.
- ❖ Të paguajë kuotën vjetore.
- ❖ Në të gjithë veprimtarinë e tij të veprojë në përputhje me normat e legjislacionit. Anëtari ka detyrim të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, dhe në rast mos prezence mund të paraqësohet me delegim të





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

prezumuar automatikisht në këto mbledhje nëpërmjet kryetarit të degës lokale të shoqatës, apo me autorizim të thjeshtë ndaj cdo anëtari tjetër të shoqatës.

Përfundimi i Anëtarësisë

Neni 22

22.1. Anëtarësia përfundon kur anëtari vdes, largohet ose përjashtohet.

Neni 23

23.1. Çdo anëtar mund të largohet nga Shoqata me vullnetin e tij të lirë duke njoftuar me shkrim Këshillit Ekzekutiv.

Neni 24

24.1. Anëtari mund të heqë dorë nga anëtarësia (të largohet) në çdo kohë duke paraqitur një letër largimi njërit prej organeve drejtuese.

24.2. Titullari i këtij organi njofton sa më parë Kryetarin e Këshillit Ekzekutiv, i cili ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm që të kryejë procedurat për fshirjen e emrit nga regjistri i anëtarëve.

24.3. Në rastin e heqjes dorë, anëtarësia pushon në momentin e çregjistrimit nga regjistri i anëtarëve.

24.4. Detyrimi për pagimin e kuotës së antarësimit (në qoftë se ekziston) pushon që në momentin e paraqitjes së letrës së largimit në njërin nga organet drejtuese.

24.5. Procedura e heqjes dorë nga anëtarësia përcaktohet në rregulloren e brendshme.

Neni 25

25.1. Përjashtimi nga shoqata kryhet sipas dispozitave për masat disiplinore të parashikuara në këtë statut dhe në rregulloren e brendshme.

Neni 26

26.1. Këshillit Ekzekutiv mund të vendosë masa disiplinore kundrejt anëtarëve, grupimeve apo organizatave nëse ata veprojnë në kundërshtim me Statutin apo me parimet themelore të shoqatës.

26.2. Një anëtar, grupimi apo organizate mund t'i hiqet me afat kohor ose përgjithmonë (të përjashtohet) e drejta e anëtarësisë ose e drejta e ushtrimit të funksioneve drejtuese, të parashikuara në Statut, kur ai me dashje shkel Statutin e shoqatës, kur shkel rëndë parimet themelore të programit të saj apo kur kryen veprime apo shfaq ose manifeston çfarëdolloj qëndrimi i cili dëmton shoqatën.

26.3. Masat disiplinore janë:

- ❖ Vërejtje.
- ❖ Pezullimi i përkohshëm (me afat të caktuar) i së drejtës për të qenë anëtar apo për të mbajtur funksione drejtuese.
- ❖ Heqja e funksioneve në shoqatë
- ❖ Heqja e së drejtës për të qenë anëtar i shoqatës.

26.4. Heqja e së drejtës për të qenë anëtar motivohet me shkrim nga ana e Këshillit





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

Ekzekutiv dhe një kopje e vendimit i jepet anëtarit, grupimit apo organizates.
26.5. Kundër vendimit mund të ushtrohet ankim pranë Asamblesë së Përgjithshme; vendimi i së cilës mund të ankimoret në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 27

27.1. Qëndrime që dëmtojnë organizatën janë:

- ❖ Abuzimi me pasurinë materiale, emrin e mirë e reputacionin e shoqatës.
- ❖ Përkatësia në një organizëm tjetër që është haptazi në konflikt interesash dhe dëmton aktivitetin apo imazhin e shoqatës.
- ❖ Veprime të cilat vetë anëtari grupimi apo organizata, kur ka detyrë në funksione drejtuese, i kryen pa marrë miratimin e organeve eprore etj.
- ❖ Pozicionimi publik a privat kundër objektivave, qëllimeve e aktiviteteve të shpallura të shoqatës.
- ❖ Dhënia apo shpërndarja e paautorizuar e informacioneve konfidenciale të shoqatës.

KREU IV

Struktura dhe funksionimi

Neni 28

28.1. Shoqata do të ketë këto strukturat organizimi:

- ❖ Asambleja e Përgjithshme;
- ❖ Këshilli Ekzekutiv
- ❖ Kryetari
- ❖ Nënkryetari
- ❖ Sekretari i Përgjithshëm

E Drejta e Përfaqësimit

Neni 29

29.1. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv, që është edhe kryetari i Shoqatës, ka të drejtën e përfaqësimit të shoqatës në marrëdhëniet me të tretët. (me personat juridik privat apo publik, me organet shtetërore e gjyqësore)

29.2. Në pamundësi të ushtrimit të kësaj të drejte nga Kryetari, me delegim prej tij të drejtën e përfaqësimit e ushtron Nënkryetari i Këshillit Ekzekutiv.

Asambleja e Përgjithshme

Neni 30

30.1. Organi më i lartë vendimmarrës i shoqatës është Asambleja e Përgjithshme e cila mbledhet jo më pak se një herë në vit, në mbledhjen e zakonshme të tij.

30.2. Asambleja thirret nga Kryetari Këshillit Ekzekutiv, nga 2/3 e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv ose nga 1/5 e anëtarëve të Asamblesë.

30.3. Asambleja mbledhet edhe vetvetiu me kalimin e afatit 1 (një) vjeçar nga mbledhja e saj e fundit. Kjo mbledhje nuk është e vlefshme në qoftë se numri shumë i vogël i pjesëmarrësve nuk lejon vendimmarrjen sipas shumicave të kërkuara në statut.





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

30.4. Data e zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe rendi i ditës njoftohen jo më pak se një muaj para ditës së mbledhjes.

30.5. Çdo anëtar ka të drejtën e votës. Në mbledhje e në votime pranohet prokura e dhënë një anëtar, i cili nuk mund të përfaqësojë më shumë se dy vota, të vetën dhe atë nga i cili ka marrë prokurë.

30.6. Mbledhjet e asamblesë drejtohen nga Kryetari e në mungesë të tij nga nënkryetari

30.7. Kryetari, ose përfaqesuesi i çdo grupimi ose organizate me më shumë se 15 antarë është njëkohësisht dhe antar i Asamblesë së Përgjithshme

Neni 31

31.1 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë si më poshtë:

❖ Zgjedh Këshillin Ekzekutiv, Kryetarin, Nënkyetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të shoqatës, me votim të hapur i cili mund të realizohet edhe me korrespondencë sipas mënyrës të përcaktuar në rregulloren e shoqatës.

❖ Miraton programin dhe planin e zhvillimit të shoqatës, si dhe ndryshimet në të

❖ Miraton rregulloret e brendshme të shoqatës.

❖ Verifikon mandatet e anëtarëve

❖ Mbikëqyr dhe kontrollon aktivitetin e Këshillit Ekzekutiv, Kryetarit, nënkryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm

❖ Analizon dhe miraton raportet financiare si dhe buxhetin për periudhën tjetër financiare.

❖ Përcakton veprimet strategjike dhe plan-veprimin e Këshillit Ekzekutiv dhe cakton veprimet prioritare.

❖ Shqyrton dhe vendos për kërkesat e bëra nga anëtarët përsa i përket aktiviteteve ose angazhimeve që duhet të përfshihen në plan për veprimin e shoqatës.

❖ Zgjedh ose shkarkon anëtarët e Këshillit Ekzekutiv me një shumicë prej së paku 2/3 e anëtarëve të saj.

❖ Miraton statutin ose ndryshimet e tij më me një shumicë prej së paku 3/5 e anëtarëve të saj.

❖ Miraton vendime dhe akte të tjera që janë me rëndësi për veprimtarinë e shoqatës

❖ Realizon edhe detyra të tjera nga lëmi i aktiviteteve sportive.

Vendimet dhe aktet e dala nga Asambleja nënshkruhen nga Kryetari ose nënkryetari, kur ai e ka të deleguar këtë të drejtë shprehimisht nga Kryetari.

Neni 32

32.1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është e vlefshme kur marrin pjesë 50 % +1 e anëtarësisë së organizatës.

32.2. Në qoftë se kjo shumicë nuk mund të arrihet, atëherë mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet.

32.3. Brenda 30 ditëve organizohet e mbahet një mbledhje tjetër e Asamblesë së Përgjithshme e cila është e vlefshme në çdo rast me ata anëtarë që paraqiten.

Neni 33





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

33.1. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet me 50% + 1 të pjesëmarrësve përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut.

Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme

Neni 34

34.1. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet dhe në raste të posaçme për shqyrtimin e çështjeve të rëndësisë së veçantë në kompetencë të saj për të cilat nuk mund të pritet mbledhja e radhës.

34.2. Kjo Asamble mbledhet kur e kërkojnë, Këshilli Ekzekutiv, ¼ e anëtarëve të Asamblesë ose Kryetari i Këshillit Ekzekutiv

34.3. Në këtë rast njoftimet realizohen 15 ditë para mbledhjes në të cilët duhet të jenë përcaktuar data e mbledhjes dhe rendi i ditës.

Neni 35

35.1. Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Asamblesë së Përgjithshme e kanë:

- a) Këshilli Ekzekutiv
- b) Kryetari i Këshillit Ekzekutiv
- c) Jo më pak se 1/5 e anëtarësisë;

35.2. Kërkesat për rendin e ditës dhe kandidaturat që do të votohen duhen depozituar pranë Këshillit Ekzekutiv të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

35.3. Kërkesat dhe kandidaturat e paraqitura pas këtij afati mund të pranohen vetëm pas miratimit të Këshillit Ekzekutiv dhe në qoftë se ka pasur arsye të motivuara për mosparaqitjen e kërkesës apo për rëndësinë e madhe të kësaj kërkesë.

35.4. Kërkesat e paraqitura edhe një herë pas rrëzimit të tyre nuk pranohen nga Këshilli Ekzekutiv dhe nuk i kalojnë Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtim.

Këshilli Ekzekutiv

Neni 36

36.1. Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) persona,që janë:

- Kryetari i Këshillit Ekzekutiv
- Nënkryetari Këshillit Ekzekutiv
- Sekretari i Përgjithshëm
- Anëtarë të tjerë.

Neni 37

37.1. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv do të kryejnë detyrat e tyre me mirëbesim, besnikëri, kujdes të plotë dhe në interes të organizatës.

37.2. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv raportojnë për veprimtarinë e tyre dhe plan veprimet për të ardhmen para Kryetarit të Këshillit dhe Asamblesë së Përgjithshme.

37.3. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj reputacionit të shoqatës, kur ky dëm është shkaktuar me dashje.





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

Mandati dhe shpërblimi

Neni 38

- 38.1. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
- 38.2. Mandati vazhdon deri në fund të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme e cila kryen zgjedhjen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Ekzekutiv.
- 38.3. Në rast vdekje, dorëheqjeje, largimi apo përjashtimi të njërit nga anëtarët e Këshillit Ekzekutiv apo disave prej tyre ky i fundit cakton/kopton një apo disa anëtarë të tjerë të këshilli.
- 38.4. Ky vendim merret me 2/3 e anëtarëve të mbetur të Këshillit Ekzekutiv dhe mandati i këtyre anëtarëve zgjat deri në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme e cila ka të drejtë të miratojë ose jo vendimin e Këshillit Ekzekutiv.
- 38.5. Anëtarët e këshillit ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë vullnetare.
- 38.6. Ata mund të kenë të drejtën e pagesës, kompensimit të shpenzimeve të kryera për ushtrimin e veprimtarisë së tyre si dhe shpërblime të tjera të kësaj natyre. Këto pagesa bëhen në varësi të punës dhe të ardhurave të organizatës, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme.

Neni 39

- 39.1. Kompetencat e Këshillit Ekzekutiv janë si më poshtë:
- ❖ Zbaton qëndrimet, rekomandimet, konkluzionet dhe vendimet e Asamblesë së shoqatës.
 - ❖ Shqyrton dhe debaton sipas rekomandimeve, konkluzioneve dhe vendimeve të organeve të shoqatës dhe ndërmerr masa për realizimin e tyre
 - ❖ Shqyrton e verifikon llogaritë periodike dhe llogaritë e vitit financiar.
 - ❖ Përcakton dhe propozon programin, raportin 1 vjeçar, llogaritë dhe planin financiar të shoqatës për çdo vit ushtrimor
 - ❖ Propozon ndryshimet dhe plotësimet në statutin e shoqatës
 - ❖ Kujdeset për realizimin e bashkëpunimit të shoqatës me organet, institucionet etj. të caktuara në këtë statut.
 - ❖ Miraton aktet e përgjithshme për punën e shërbimit profesional të shoqatës
 - ❖ Vendos për pranimin e punëtorëve në shërbimin profesional të shoqatës
 - ❖ Cakton forma të përhershme dhe të përkohshme të veprimit, zgjedh kryetarët dhe emëron anëtarët e përbërjes së tyre si dhe verifikon planet e punës dhe mbikëqyr punën e këtyre formave të veprimit të shoqatës
 - ❖ Organizon këshillime, seminare tematike, simpoziume etj, nga fushëveprimtaria dhe aktivitetet e saj
 - ❖ Ndihmon Kryetarin e Këshillit Ekzekutiv në realizimin e aktivitetit të përditshëm dhe programeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
 - ❖ Ndihmon Kryetarin në përgatitjen e projekt – programit, planit të veprimit, projekt - programin e aktiviteteve vjetore dhe projekt – buxhetin të cilët i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim.
 - ❖ Bashkëpunon me organizata të tjera vendase dhe të huaja për kryerjen e detyrave





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

të tij dhe realizimin e qëllimeve dhe objektivave të organizatës.

- ❖ Vendos momentin e fillimit të pagimit të kuotave dhe masën e saj me shumicën e prej 5/7 të anëtarëve të tij.
- ❖ Vendos mbi ndarjen e mirënjohjeve aktivistëve dhe institucioneve të dalluara
- ❖ Përgatit dhe përcakton propozimet e vendimeve që janë në kompetencë të Asamblesë të shoqatës
- ❖ Merr në shqyrtim kërkesat për pranimin e anëtarëve të rinj në organizatë.
- ❖ Miraton vendime e akte të tjera që kanë të bëjnë me punën e shoqatës që nuk janë në kompetencë të Asamblesë.

Neni 40

- 40.1. Vendimet e Këshillit Ekzekutiv merren me shumicë të thjeshtë kur nuk parashikohet ndryshe në këtë statut .
- 40.2. Vendimet janë të vlefshme kur merren nga 50% +1 e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, përveç rasteve kur në statut përcaktohet një shumicë e cilësuar. Në këtë rast vendimi është i vlefshëm në qoftë se votojnë të gjithë anëtarët e këshillit.
- 40.3. Rastet e pamundësisë së marrjes së vendimeve rregullohen sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të shoqatës.

Kryetarit të Shoqatës dhe Këshillit Ekzekutiv

Neni 41

- 41.1. Kryetari i shoqatës është dhe kryetari i Këshillit Ekzekutiv. Ai zgjidhet nga Asambleja e përgjithshme me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
- 41.2. Drejton veprimtarinë e Këshillit Ekzekutiv dhe është përgjegjës për transparencën e vendimeve të marra nga ky organ.
- 41.3. Përfaqëson shoqatën në marrëdhënie me të tretët, me shoqatat analoge brenda dhe jashtë vendit, në gjykatë, në realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të lindura nga këto marrëdhënie në përputhje me dispozitat e K. Civil dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, përveç kur parashikohet ndryshe.
- 41.4. Merret me punët e përditshme të Këshillit Ekzekutiv.
- 41.5. Thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv.
- 41.6. Koordinon veprimtarinë e takimet me të tretët dhe raporton para Asamblesë dhe Këshillit Ekzekutiv.
- 41.7. Koordinon veprimtarinë e të gjithë strukturave të shoqatës.
- 41.8. Mundëson realizimin e aktivitetit të përditshëm dhe realizon programet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- 41.9. Përgatit projekt - programin e aktiviteteve vjetore, plan veprimet dhe projekt - buxhetin respektiv që i prezantohet Asamblesë për miratim.
- 41.10. Përgatit projekt - propozime në mënyrë që të rrisë mundësinë e përmbushjes së qëllimeve të organizatës që janë cituar në akt themelim dhe në statut.
- 41.11. Administron projektet dhe programet si dhe identifikon e cakton përgjegjësit, koordinatorët, aktivistët e pjesëmarrësit e tjerë në to.
- 41.12. Grumbullon informacion dhe rekomandime të nevojshme për realizimin e





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

- objektivave të organizatës dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj.
- 41.13. Bashkëpunon me organizata të tjera vendase dhe të huaja.
 - 41.14. Mbledh Asamblenë e Përgjithshme sipas grafikut të pranuar në takimin pararendës dhe me asistencën e Sekretarit dhe Financierit, duke marrë masat për shpërndarjen e dokumentacionit që do të diskutohet në takim.
 - 41.15. Mund të thërrasë Asamblenë së përgjithshme të jashtëzakonshme për arsye shumë urgjente.
 - 41.16. Nënshkruan aktet dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Ekzekutiv

Neni 42

Nënkryetari

- 42.1. Nënkryetari i Shoqatës zëvendëson Kryetarin, në rastet kur ai është i sëmurë ose është larguar për një kohë më shumë se dy muaj nga Shqipëria dhe me anë të një prokure nga Kryetari i jepen tagrat që ai ka ose qo do t'ia kalojë.

Neni 43

Sekretari i Përgjithshëm dhe kompetencat

- 43.1. Sekretari i Përgjithshëm, është anëtar i Këshillit Ekzekutiv dhe kujdeset për organizimin faktik të Mbledhjes së Përgjithshme, për njoftimin e anëtarëve, përgatitjen e materialeve të ndryshme që do t'i shërbejnë Mbledhjes së Përgjithshme, kujdeset për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes duke e mbajtur vetë ose duke caktuar një person tjetër për mbajtjen e tij, të miratuar nga Asambleja.
- 43.2. Ai është mbajtës i vulës dhe firma e dytë e të gjithë akteve që dalin në emër të shoqatës.
- 43.3 Mban regjistrin e anëtarëve të organizatës;
- 43.4.1. Kryen procedurat e parashikuara në këtë statut e në rregulloren e brendshme të organizatës për regjistrimin e anëtarëve të rinj;
- 43.4.2. Mban dosje me të dhënat e dokumente të tjera të Anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, Kryetarit, nënkryetarit, të komiteteve apo komisioneve të veçanta dhe të grupeve të punës, të punësuarve e vullnetarëve të organizatës (në qoftë se ka);
- 43.4.3. Mban procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme si dhe të takimeve të rëndësishme të kryera nga Kryetari apo përfaqësuesit e tjerë të organizatës me të tretët si dhe librin e Mbledhjeve të Asamblesë dhe Këshillit Ekzekutiv
- 43.4.4. Regjistron pjesëmarrjen e anëtarëve të organeve drejtuese në aktivitetet e ndryshme të organizatës;
- 43.4.5. Kujdeset për korrespondencën e komunikimet e tjera zyrtare të organizatës;
- 43.4.6. Mban kontakte të vazhdueshme me Degët e shoqatës dhe informon Kryetarin për mbarëvajtjen e punëve;
- 43.4.7. Kujdeset për çështje të ndryshme teknike të shoqatës si blerjet e vogla, regjistrimi i orarit të të punësuarve e vullnetarëve të organizatës (në qoftë se ka)
- 43.4.11. Udhëheq, orienton dhe koordinon punën e shërbimit profesional me qëllim të





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

- zbatimit me kohë të punëve dhe detyrave të punëve profesionale, financiare e administrative-teknike të shoqatës;
- 43.4.13. Çdo kompetencë tjetër që i caktohet nga Asambleja, Kryetari ose Këshilli Ekzekutiv;
- 43.4.14. Nëse është e domosdoshme mund të krijohen marrëdhënie pune në kohë të përcaktuar, sipas vendimit të Këshillit Ekzekutiv
- 43.3.15. Gjithashtu, mund të kryejë detyra që i ngarkohen posaçërisht nga Kryetari apo nga Nënkryetari i Shoqatës.

Neni 44

- 44.1. Sekretari i Përgjithshëm mund të ndihmohet nga një ose disa asistentë në kryerjen e këtyre detyrave. Ata caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm me miratimin e Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv.
- 44.2. Të gjithë veprimet e asistentit/asistentëve quhen si të kryera nga vetë Sekretari i Përgjithshëm. Ai mban përgjegjësi në rast abuzimi apo shkaktimi dëmi material apo të emrit e të reputacionit të organizatës.

Krijimi i grupeve të punës

Neni 45

- 45.1. Tre ose më shumë anëtarë të Organizatës kanë të drejtë të krijojnë një grup pune për realizimin e një projekti të caktuar veçmas ose në bashkëpunim me sektorët përkatës.
- 45.2. Ata i drejtojnë një kërkesë kryetarit i cili vendos për njohjen e grupit dhe miratimin e projekt idesë.
- 45.3. Në rast miratimin e saj, kryetari cakton një koordinator nga organet drejtuese mundësisht nga sektori që ka më tepër lidhje me natyrën e projektit si përfaqësues i këshillit ekzekutiv dhe kryetarit për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e projektit.

Neni 46

- 46.1. Me qëllim të zbatimit me sukses të detyrave të programuara e të caktuara në këtë statut dhe në Programin e shoqatës, me vendim të Asamblesë mund të formohet shërbimi profesional
- 46.2. Ky shërbim kryhen veprimtarinë në plotësim të detyrave profesionale-analitike, financiare dhe administrative –teknike
- 46.3. Rregullat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në shërbimin profesional caktohen në rregulloren e shoqatës

Neni 47

- 47.1. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv dhe Kryetarët e komisioneve/komiteteve të veçanta e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë vullnetare.
- 47.2. Ata mund të kenë të drejtën e pagesës, kompensimit të shpenzimeve të kryera për ushtrimin e veprimtarisë së tyre si dhe shpërblime të tjera të kësaj natyre. Këto pagesa bëhen në varësi të punës dhe të ardhurave të organizatës, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme.





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

Shkëmbimi i Informacionit

Neni 48

48.1. Në mënyrë që të përmbushen qëllimet, anëtarët do të shkëmbejnë informacion që ka lidhje me realizimin e qëllimeve të organizatës.

48.2. Anëtarët janë të detyruar t’i përgjigjen direkt kërkesave për këtë lloj informacioni nga anëtarët e tjerë të Këshillit Ekzekutiv

Përdorimi i Informacionit

Neni 49

49.1. Çdo anëtar ka të drejtë të mbajë, të shkëmbejë dhe të japë informacion që ka lidhje me realizimin e qëllimeve të organizatës.

49.2. Çdo anëtar është i detyruar të mbajë konfidencialitetin e këtij informacioni.

49.3. Publikimi i informacionit ose pasurisë së Organizatës në masmedia lejohet vetëm me pëlqimin e Këshillit Ekzekutiv.

Neni 50

50.1. Informimi i popullsisë lidhur me punën dhe aktivitetin e shoqatës bëhet nëpërmjet TV, radiostacioneve publik e lokale shtetërore e private për informim publik si dhe nëpërmjet medias së shkruar

50.2. Shoqata do të botojë Buletinin e vet me qëllim të informimit të anëtarëve dhe të opinionit publik

Konflikti i interesave dhe marrëveshjet e ndaluara

Neni 51

51.1. Nuk lejohet konflikti i interesave ndërmjet organizatës jofitimprurëse dhe anëtarit të organizatës vendimmarrës, ekzekutiv dhe punonjësit të saj.

51.2. Marrëveshjet ndërmjet organizatës dhe një anëtarit të organeve drejtuese, mund të lejohen vetëm nëse ato lidhen për të përmbushur një qëllim ose objekt të veprimtarisë së organizatës dhe në çdo rast me vendim nga Këshillit Ekzekutiv. Në kohën e shqyrtimit nga Këshillit Ekzekutiv, këta anëtarë përjashtohen nga diskutimi dhe votimi.

51.3. Në rast konflikti i interesave ose marrëveshje të ndaluara ose të konsumuar dhe në rast se procedurat e mësipërme nuk janë ndjekur, vetë Këshillit Ekzekutiv mund të anulojë këtë marrëveshje dhe të kërkojë një dëmshpërblim.

Neni 52

52.1. Me Vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës ngrihet Komisioni i Kontrollit ekonomik-financiar i përbërë të paktën prej tre anëtarëve.

52.2. Ai ka për detyrë të verifikojë e kontrollojë gjithë veprimtarinë e Shoqatës, organeve drejtuese të saj si dhe të Degëve. Për kontrollin e ushtruar raporton me shkrim në mbledhjen e përgjithshme të shoqatës duke sugjeruar masat përkatëse dhe mënyrën e eliminimit të të metave të konstatuara.

52.3. Kur votohen aktet e paraqitura prej tij në Mbledhjen e Përgjithshme anëtarët e komisionit nuk kanë të drejtë vote.





"FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE" Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

Neni 53

- 53.1 Me vendim të Asamblesë së përgjithshme emërohet eksperti kontabël i autorizuar.
- 53.2 Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e ekspertit kontabël te autorizuar zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- 53.2. Eksperti merr pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe Këshillit Ekzekutiv sipas dëshirës së tij ose kur kjo i kërkohet nga vetë këto organe, pa të drejtë vote, por mund të propozojë çështje të ndryshme për diskutim brenda kompetencave të tij.

KREU V

Transformimi dhe bashkimi

Neni 54

- 54.1. Shoqata mund të transformohet ose të bashkohet me organizatë/a tjetër/ të tjera për të siguruar avancimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të saj.
- 54.2. Vendimi për rastet e parashikuara në nenin 54.1. merret nga Asambleja e Përgjithshme me 3/5 e anëtarëve të shoqatës.
- 54.3. Shoqata konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Shpërndarja e shoqatës

Neni 55

- 55.1. Shoqata shpërndahet:
- ❖ Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të thirrur vetëm për këtë qëllim dhe me miratimin e 3/5 të anëtarëve të shoqatës.
 - ❖ Kur numri i anëtarëve është nën minimumin e lejuar nga ligji dhe statuti
 - ❖ Kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet
 - ❖ Kur transformohet apo bashkohet me organizatë/a tjetër/ të tjera
 - ❖ Me Vendim të gjykatës kompetente kur ajo është larguar nga qëllimi i caktuar në statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjshme

Likuidimi

Neni 56

- 56.1. Kur vendoset shpërndarja e shoqatës nga vete ajo likuidimin e kryejnë një ose disa likuidatorë të caktuar nga Asambleja
- 56.2. Vendimi merret me kuorumin e ¾ të votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm
- 56.3. Kur Asambleja nuk mund të caktojë likuidatorin/likuidatorët , caktimi i tij/tyre bëhet nga Gjykata me kërkesën e Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv ose të çdo personi të interesuar.
- 56.4. Kur shpërndarja e shoqatës vendoset nga Gjykata, ajo cakton dhe likuidatorin
- 56.5. Me caktimin e likuidatorit/likuidatorëve përfundojnë funksionet e Këshillit Ekzekutiv dhe të drejtuesve të tjerë të shoqatës.

Neni 57

- 57.1. Brenda dy muajve pas caktimit të tyre, likuidatori ose likuidatorët kërkojnë një





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

takim të Asamblesë së Përgjithshme për të prezantuar situatën financiare dhe kërkojnë një raport situacional për procedurën e mbylljes.

Të Drejtat dhe Detyrat e Likuidatorit

Neni 58

- 58.1. Likuidatorët kanë të drejta dhe përgjegjësi mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e shoqatës që nga dita e emërimit të tyre dhe deri në likuidimin e plotë të shoqatës.
- 58.2. Likuidatori përfaqëson shoqatën dhe ka kompetencat profesionale për procedurat e likuidimit.
- 58.3. Ai/Ajo është i/e autorizuar të shlyejë të gjitha detyrimet e mundshme.





“FEDERATA E ORNITOLOGËVE SHQIPTARE” Rr. Asim Voksi, Nd.10,H4,Ap3, KP. 1016,TIRANE.,
Cel: 0665699034, 0682046950, Tirane

KREU VI **Dispozita të fundit**

Përbërja e Organeve të organizatës

Neni 60

60.1. Asambleja e Përgjithëshme përbëhet nga anëtarët që janë: *(emrat)*

60.2. Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga: *(emrat)*

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Neni 61

61.1. Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve të tjera zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e organizatës.

61.2. Në të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 62

62.1. Ky Statut përgatitet në 4 (katër) ekzemplarë origjinal në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, për përmbajtjen e të cilit anëtarët kanë rënë dakord dhe zotohen për zbatimin me besnikëri të tij.

ANËTARËT

(emrat dhe firmat e tyre)

